

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TE KOSOVES

Në pajtim me autoritetin që i është dhënë në nenin 17.b të rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/24, të datës 1 Tetor, 2001 mbi amandamentin e rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/20, mbi Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës, dhe nenit 3.3 të rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/25 të datës 5 Tetor, 2001 mbi licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullat e kompanive të sigurimit dhe ndërmjetësuesve të sigurimit.

Me qëllim të zbatimit të nenit 56 të rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/25

Bordi Drejtues i Autoritetit Bankar dhe i Pagesave të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 28 Mars, 2002 ka miratuar me sa vijon:

Rregulli 27 mbi Transaksionet me Palët e Afërta

Neni 1

1. Shtrirja e Rregullit

Ky Rregull aplikohet për të gjitha kompanitë e sigurimit dhe ndërmjetësuesit e sigurimit të licencuar nga BPK-ja.

2. Autoriteti Ligjor

Ky rregull implementon nenin 56, të kapitullit VIII të rregullores së sigurimeve.

3. Definicionet

Në këtë rregull, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

“Anëtarësimi” apo “Kompanitë e antarësuar” e kanë kuptimin ashtu siç është definuar në nenin 1 të rregullores së sigurimeve. Në këtë rregull termi anëtarësim apo i kompanisë të antarësuar përfshinë edhe vartësin apo vartësit.

“Bordi i drejtorëve” nënkupton nivelin më të lartë të trupit qeverisës të një korporate të përbërë nga anëtarët e caktuar nga e drejta e votës së aksionarve. Në këtë rregull, termi “bordi i drejtorëve” i referohet:

- a) Në rast të një korporate apo kompanie të krijuar dhe që ekziston nën ligjet e Kosovës, bordi i drejtorëve e organizon vetën.
- b) Në rast të kompanisë së huaj të inkuorporuar në juridiksion tjetër, por e cila është e licensuar të merret me biznesin e sigurimeve në Kosovë, zyrtari i lartë i zyrës së kompanisë në Kosovë, i cili është banor i Kosovës dhe i pranuar si i till nga BPK-ja.

“Bordi” i referohet bordit të drejtorëve siç është i definuar në këtë rregull.

“Komiteti” i referohet komitetit udhëheqës të shqyrtimeve i krijuar nga bordi siç është përshkruar në rregullen 24, mbi qeverisjen e korporatës.

“Kompania e licensuar” apo “Kompania” i referohet njerës apo të dyjave, kompanisë së sigurimeve apo ndërmjetësuesve të sigurimit.

“Përshkrimi i klasave të të punësuarve” duhet të definohet nga komiteti udhëheqës i shqyrtimeve, i cili duhet të përfshij të gjithë punëtorët që kanë kujdestari mbi mjetet e kompanisë apo kanë qasje në informatat financiare të kompanisë.

“Transaksionet me palët e afërta” i referohet, në përgjithësi, transaksioneve në mes kompanisë së licensuar dhe një personi të afërm të asaj kompanie të licensuar. Në veqanti, i referohet transaksioneve në mes paleve të afërta, siç është definuar në këtë rregull.

“Zyrtari I lartë” është zyrtari I nivelit më të lartë I një kompanie të sigurimit apo ndërmjetësuesi të sigurimit, pamarrparasysh se a e përdorë titullin e “Kryetarit”, “Nënkryetarit”, “drejtorit menaxhues”, “pëfaqësuesit të shtetit”, “menaxherit”, apo ndoj titull tjetër të tillë.

“Vartësit” e kanë kuptimin siç është definuar në nenin 1 të rregullores së sigurimeve. Në këtë rregull, termi “vartës” përfshinë anëtarësimin apo kompaninë e antarësuar.

Neni 2

Miratimi i Politikës dhe Procedurave Lidhur me Transaksionet me Palët e Afërta

1. Përgjegjësia e Bordit

Një nga kërkesat për shkarkim nga përgjegjësitë tutoriale të bordit është ndalesa dhe kontrolli i transaksioneve me palët e afërta, të cilat e prekin kompaninë. Nga bordi kërkohet që menjëherë të krijoj komitetin udhëheqës të shqyrtimeve në pajtim me rregullin 24. Komiteti duhet, që brenda dyzet e pesë (45) ditëve nga konstituimi, ta siguroj BPK-së politikat e shkruara dhe procedurat e miratuara, dhe të zbatuara në udhëheqjen e biznesit të kompanisë, që ka të bëjë me qështjet e involvimit të transaksioneve me palët e afërta, në pajtim me nenin 56 të rregullores së sigurimeve dhe kësaj rregulle.

2. Palët e Afërta

Në nenin 56 të rregullores së sigurimeve dhe në këtë rregull:

Palë e afërt nënkupton personin i cili:

- a) Është drejtor, zyrtarë apo anëtarë i kompanisë.
- b) Është një punëtorë i kompanisë apo anëtarë i saj dhe është nga klasa apo kategoria e përshkruar si punëtorë i influencuar.
- c) Zotëron apo kontrollon, në mënyrë direkte apo indirekte, 10% apo më shumë të drejtës së votës së aksionarve në kompani apo në anëtarësin e saj.
- d) Është anëtarë i kompanisë.
- e) Është korporatë apo entitet ligjor të cilën kompania zotëron apo anëtarësia e saj zotëron apo kontrollon, në mënyrë direkte apo indirekte, 10% apo më shumë të drejtës së votës së aksionarve.
- f) Zotëron apo kontrollon, në mënyrë direkte apo indirekte, 10% apo interes më të madhë në një ndërmarrje të përbashkët, në të cilën kompania apo anëtarësia e saj po ashtu zotëron apo kontrollon në mënyrë direkte apo indirekte, 10% apo interes më të madhë.
- g) Zotëron apo kontrollon, në mënyrë direkte apo indirekte, 10% apo interes më të madhë në partneritet në të cilin kompania apo anëtarësia e saj po ashtu zotëron apo kontrollon në mënyrë direkte apo indirekte, 10% apo interes më të madhe.
- h) Është praktikant i cili është revizor apo ekspert i sigurimeve (aktuar) apo këshilltar i kompanisë apo anëtarësisë së saj.
- i) Është në mënyrë aktive i angazhuar në revizionimin e kompanisë apo anëtarësisë së saj apo është partner në partneritetin i cili e kryen revizionin e kompanisë apo anëtarësisë së saj.

- j) Është drejtor, zyrtarë apo punëtorë i klasës së përshkruar, në korporatë e cila është palë e afërt si në paragrafin e mësipërm c) dhe d).
- k) Është bashkshort i një individ i cili është palë e afërt si në paragrafet e mësipërme a), b), c), dhe d), apo në alinenë 3 të këtij neni.
- l) Është i afërm apo një individ, apo bashkshort i një indivi të tillë, i cili është palë e afërt si në paragrafet e mësipërme a), b), c), dhe d) dhe i cili ka shtëpi të njëjtë me personin.
- m) Është korporatë në të cilën një person i cili është palë e afërt si në paragrafet e mësipërme a) deri në g) apo paragrafet e mësipërme f) deri në l), apo si në alinenë 3 të këtij neni, ka kontroll, në mënyrë direkte apo indirekte, në më shumë se pesëdhjetë (50%) përqind të votave të cilat mund të llogariten në zgjedhjen e drejtorit të korporatës.

3. Vazhdimësia e Statutit të Palëve të Treta

Një individ i cili, duke qenë palë e afërt, pushon së qeni një nga ata të përmendur më lartë si në alinen 2 të këtij neni, megjithatë vazhdon, për qëllime të kësaj rregulle, të jetë palë e afërt në kompani për një periudh prej 12 muajsh, duke filluar nga dita kur individ i ka pushuar të jetë palë e afërt si në alinen 2 të kësaj rregulle.

Neni 3

Kufizimet mbi Vetsjelljen si Tutor

1. Investimet dhe Përdorimi i Mjeteve Tutoriale

Përveq se si është theksuar në këtë rregull apo siç mund të lejohet nga direktivat që pasojn te BPK-së, një kompani e cila i mbanë mjetet në zotësi tutoriale nuk duhet të:

- a) Investoj ato mjete apo një pjesë të tyre në letra me vlerë apo obligime të lëshuara nga kompania apo nga palët e afërta të kompanisë.
- b) Të përdorë mjetet apo një pjesë të tyre në ndonjë transaksion me palët e afërta të kompanisë

2. Kompania si Zëvendësues i Tutorit në Truste apo Patundshmëri

Kompania mund të zëvendësoj dhe të jetë si administrator, pranues apo tutor me zotësi tjera në truste apo patundshmëri në të cilat letrat me vlerë janë të mbajtura dhe të cilat

janë lëshuar nga kompania apo nga ndonjë palë e afërt e saj, nëse këto direktiva plotësohen:

- a) Letrat me vlerë janë fituar nga një person për të cilin trusti apo patundshmëria, është si tutor; apo nëse letrat me vlerë vetëm janë mbajtur si trustee apo patundshmëri; para se kompania ti ketë supozuar përgjegjësitë tutoriale për trustee të tilla apo patundshmëri.
- b) Kompania apo palët e saj të afërta nuk duhet t'i shesin apo t'i votojn letrat me vlerë apo të refuzojn ndonjë ofertë për to pa miratim të shkruar të komitetit; edhe atë komiteti duhet ti parashtrijë arsyet e shitjes, votimit apo refuzimit në procesverbalin e saj.
- c) Komiteti duhet që brenda pesëmbdhjetë (15) ditëve, të cdo viti, të siguroj një raport të shkruar bordit mbi letrat me vlerë të cilat janë:
 - (i) Lëshuar nga kompania apo nga pala e afërt e saj, dhe janë mbajtur në trustee apo patundshmëri nga kompania si tutor gjatë vitit financiar paraprirës, dhe
 - (ii) Të jap arsyet për cdo miratim të dhënë apo të refuzuar si në paragrafin e mësipërm b).

Neni 4

Kufizimet mbi Transaksionet me Palët e Treta

1. Kufizimet e Përgjithshme

Përveq se si është e lejuar në këtë rregull apo nga miratimi i shkruar i BPK-së:

- a) Kompania apo anëtarësia e saj, në mënyrë direkte apo indirekte, nuk duhet t'i jap biznes një pale të afërt në mënyrë të huas, garancisë, rezervat e letrave me vlerë apo investime e mjeteve të saj apo të ndoj pjese të saj, apo të hyj në ndonjë transaksion me palën e afërt.
- b) Pala e afërt apo anëtarësia, në mënyrë direkte apo indirekte, nuk duhet të jap biznes kompanisë në mënyrë të huas, garancisë, rezervat e letrave me vlerë apo investime të mjeteve të saj apo ndonjë pjese të saj, apo të hyj në transaksion me kompaninë.

2. Kufizimet Specifike

Një kompani apo anëtarësia e saj, në mënyrë direkte apo indirekte, nuk duhet të:

- a) Hyj apo të bëj ndonjë transaksion specifik me palën e afërt që është miratuar nga komiteti për konsiderata, dhe që është materialisht më e madhe apo më e vogël se vlera e tregut të drejtë, nga komiteti në miratimin e tij në të shkruar.
- b) Hyj apo të bëj ndonjë transaksion në klasën e transaksioneve me palët e afërta, të miratuar nga komiteti që është për konsiderim material më e madhe apo më e vogël se vlera e tregut normal.
- c) Pamarrparasysh se a është aprovuar ajo nga komiteti, hyrja apo berja e transaksionit me palën e afërt që konsiston në llogaritë e pranuar, huat, apo instrumentin e letrave me vlerë duke përfshirë mjetet, si subjekt i marëveshjes për riblerje.
- d) Pamarrparasysh se a është aprovuar ajo nga komiteti, apo është lejuar sipas kësaj rregulle, rregullimi i mjeteve, në periudhë të vijueshme 12 mujore, në favor të palës së afërt nëse vlera e mjeteve të rregulluara të secilës palë është më e madhe se dy e gjysmë (2.5%) përqind të totalit të mjeteve të kompanisë siç është dhënë në raportin e fundit financiar të revizorit dhe të arkivuar në BPK, përveq se me miratim të shkruar të BPK-së.

Neni 5

Transaksionet e Caktuara të Lejueshme me Palën e Afërt

1. Transaksionet e Lejueshme

Përveq nëse është e ndalueshme në pajtim me këtë rregull apo direktivat e BPK-së një kompani apo anëtarësia e saj mund të transaktoj me sa vijon me palën e afërt:

- a) Pagimin apo akordimin e pagës, honorarit, pensionet, benifitin apo benifitin stimulus drejtorit apo zyrtarit të kompanisë apo ndonjë personi tjetër në klasën e përshkruar të punëtorve.
- b) Paguaj, negocijoj apo transaktoj honoraret dhe pagesat e tjera aktuarit të kompanisë, revizorit apo këshilltarit të jashtëm.
- c) Dhënja palës së afërt, jo më ulët se vlera normale e tregut, produktet apo shërbimet të cilat kompania apo anëtarësia e saj i jep publikut në kursin e zakonshëm të biznesit.
- d) Të blej apo shes palës së afërt pronë që ka vlerë normale të tregut dhe që nuk e tejkalon kufizimin e përshkruar si në paragrafin d), alinea 4 e kësaj rregulle.
- e) Të blej nga pala e afërt, në jo më të ulët se vlera normale e tregut, produktet apo shërbimet të cilat pala e afërt po ashtu i jep publikut në kursin e zakonshëm të biznesit.

Neni 6

Udhëheqja e Komitetit të Shqyrtimeve

1. Fuqia për të Miratuar Transaksionet me Palët e Afërta

Kur lejohet për të bërë dhe nuk ndalohet me anë të kësaj rregulle, komiteti mund të miratoj me shkrim transaksionin me palën e afërt, nëse transaksioni, në kohën që është bërë, ose është një transaksion specifik apo klasë e transaksioneve.

Komiteti nuk duhet të miratoj një transaksion specifik apo klasë të transaksionit që është:

- a) Në klasën e transaksioneve të kufizuara, në pajtim me këtë rregull.
- b) Involvon shitjen apo blerjen e një interesi në patundshmëri përveq të interesit të kontratës së qirasë.
- c) Involvon shitjen apo rezerva tjera të interesit të kontratës së qirasë në patundshmëri e cila mund të transferoj të drejtën palës së afërt për të marrë patundshmëritë për afatin e ripërritjes fikse apo sukseseve, në shtesën prej dhjetë (10) vitesh.
- d) Involvon ndërrimin e një apo më shumë instrumente të letrave me vlerë të lëshuara nga kompania me instrumentet e letrave me vlerë të lëshuar nga palët e afërta kur instrumentet e letrave me vlerë të ndrruara nuk janë tregtuar në mënyrë publike.
- e) Jo konsistent me, apo vartës i aresyeshëm, biznesin e zakonshëm të kompanisë apo anëtarësisë së saj, siç mund të jetë rasti.
- f) Jo në interesin më të mirë të kompanisë, apo nëse ka hyrë me anë të një anëtari, jo në interesin më të mirë të kompanisë dhe anëtarëve të saj.

2. Drejtësia e Transaksionit

Komiteti nuk do të aprovoj asnjë transaksion, përveq nëse baza e tij është e kënaqshme dhe e arsyeshme.

- a) Transaksioni është hyrë dhe marrë në konsideratë, i paguar nga kompania apo anëtarësia e saj, jo materialisht më shumë se vlera normale e tregut.
- b) Transaksioni është hyrë dhe marrë në konsideratë, i pranuar nga kompania apo anëtarësia e saj, jo materialisht më pak se vlera normale e tregut.

c) Në transaksion janë të involvuara huaja apo huat nga kompania apo anëtarësia e saj.

1. Huaja apo huat duhet të sigurohen me detyrim mbi pronën e cila ka vlerë të drejtë të tregut, për ta kënaqur një hua për të vlerësuar një proporcion të 80% apo më shumë.
2. Prona e detyruar si letra me vlerë nuk është në kategorinë e mjeteve të kualitetit të ulët.
3. Komiteti kur e miraton transaksionin, duhet të specifikoj në miratimin e tij me shkrim shumën e caktuar të vlerës së tregut të drejtë të pronës së caktuar si letra me vlerë dhe aresyet të bëjnë të besosh se prona e caktuar si letra me vlerë nuk është mjet i kualitetit të ulët.

Neni 7

Zbulimi i Interesave të Palëve të Afërta

1. Për kë Është i Nevojshëm Zbulimi

Një palë e afërt e kompanisë e cila është direkt apo indirekt e interesuar në transaksion apo në një transaksion të propozuar me kompaninë apo anëtarësinë e saj për të cilën në këtë rregull kërkon miratimin e komitetit apo kontestimin e BPK-së, duhet ta zbuloj me shkrim bordit natyrën dhe shtrirjen e palës së afërt të interesuar në transaksion. Të gjitha zbulimet e tilla të dorëzuara bordit duhet të mirren dhe të shënohen në procesverbalin e mbledhjeve të bordit.

2. Palët të Cilat Kërkohen të Bëjnë Zbulimin

Palët që vijojn duhet të bëjnë zbulimin e kërkuar në këtë rregull:

- a) Palët e afërta të kompanisë apo anëtarësisë së saj në përgjithësi.
- b) Në rast se një individ i cili mendohet të jetë palë e afërt, sepse ai aso ajo është bashkshort i palës së afërt apo i afërt i palës së afërt dhe jeton në të njëjtën shtëpi me palën e afërt, zbulimi duhet të bëhet nga pala e afërt me të cilin lidhja jep ngritje individit i cili mendohet të jetë palë e afërt.
- c) Drejtori apo zyrtari i kompanisë apo anëtari i saj i cili po ashtu është drejtor apo zyrtar, apo zotëron më shumë se 50% të votës së aksionarve, në korporatë është i interesuar në transaksion apo propozon transaksion me kompaninë apo anëtarësin e saj, duhet të zbuloj lidhjen e tij me korporatën e interesuar dhe natyrën si dhe shtrirjen e interesit të korporatës në transaksion apo në transaksionin e propozuar.

3. Kur Kërkohet të Bëhet Zbulimi

Të gjitha zbulimet të kërkuara në pajtim me rregulloren e sigurimit konsistojn me këtë rregull dhe duhet të bëhen shpejt nën direktivat që vijojn:

- a) Në mbledhjen e parë të bordit të kompanisë pasi qështja që kërkon zbulim I është e njohur palës së afërt.
- b) Nëse mbledhja e përshkruar në situatën e paraqitur si më poshtë, në të njëjtën kohë apo pasi që qështja që kërkon zbulim i bëhet e njohur personit që duhet të bëj zbulimin, zbatohen këto rregulla:
 - (i) Se personi po ashtu duhet të bëj zbulimin në mbledhjen e bordit në të cilën transaksioni apo transaksioni i propozuar është konsideruar së pari.
 - (ii) Nëse personi apo korporata në të cilën personi është drejtor, nuk ishte në mbledhjen e parë të bordit, që është I interesuar në transaksion, ai person duhet të bëj zbulimin në mbledhjen e parë të bordit pasi që ai person apo korporatë të shfaqë interesim.
 - (iii) Nëse personi shfaqë interesim apo bëhet drejtor i korporatës që shfaqë interesim, pasi të jetë propozuar transaksioni apo pasi ai të jetë bërë, ai person duhet po ashtu të bëj zbulim në mbledhjen e parë pasi të ketë shfaqur interes apo të jetë bërë drejtor i një korporate të interesuar.
 - (iv) Nëse personi i cili është i interesuar në transaksion apo transaksion të propozuar, më vonë bëhet drejtor i kompanisë apo anëtarësisë së saj, ai person duhet të bëj zbulim në mbledhjen e parë të bordit pasi ai të jetë bërë drejtor i kompanisë apo anëtarësisë së saj.
- c) Një palë e afërt të cilit i kërkohet të bëj zbulim në bord, dhe që nuk është drejtor i kompanisë apo anëtarësisë së saj, duhet menjëherë të bëj zbulim pasi që interesi që kërkon zbulim për të është i njohur pamarrparasysh apo jo kompania vetëm se e ka propozuar hyrjen në transaksion me kohë.
- d) Nëse një person i cili është i interesuar në një transaksion apo transaksion të propozuar, dhe që kërkon zbulim, bëhet palë e afërt pasi transaksioni të jetë propozuar apo është hyrë në të nga kompania apo anëtarësia e saj, ai person duhet të bëj zbulim menjëherë pas interesi që kërkon zbulim i bëhet i njohur atij personi.

4. Vet-Kufizimet në Konflikt Interesash

Drejtorit të kompanisë apo anëtarësisë së saj, të cilit i kërkohet të bëj zbulim nën këto nuk duhet:

- a) Të merr pjesë në diskutim apo të votoj në ndonjë rezolutë apo të miratoj apo të mohoj një transaksion në lidhje me të cilin zbulimi është kërkuar.
- b) Të jetë prezent në asnjë mbledhje të bordit derisa bordi të merret apo të diskutoj mbi çështjen e transaksionit për të cilin zbulimi është kërkuar.
- c) Të influencoj apo të orvatet të influencoj votimin e ndonjë rezolutë, të miratoj apo mohoj një transaksion për të cilin zbulimi është kërkuar.

Neni 8
Hyrja në fuqi

Ky rregull, do të hyj në fuqi me 1 Prill, 2002

David Weatherman
Ushtrues i Detyrës së Drejtorit Gjeneral